REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:049265

Datë: 30.04.2021

Numri i dokumentit: 01751618

III.EK.nr.173/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit Avokat A. D., nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A. M., avokat nga P., kundër të paditurit C... T..., me seli në F. K., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.B., avokat nga P., objekt i kontestit: kompensim dëmi, vlera e kontestit 2,715.00 €, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor tw datws 15.04.2021, dhe pas pranimit të fjalëve përfundimtare me shkrim nga palët në procedurë, me datën 26.04.2021, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Avokat A. D., nga P., e paraqitur ndaj të paditurit C... T..., me seli në F. K., që paditësit t'ia paguaj shumën prej 2,715.00 € (dy mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) në emër të borxhit të dalë nga marrëveshja për shërbime juridike, me kamatë prej 8%, në vit e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë dt.04.05.2020, e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësi Avokat A. D., nga P., përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 04.05.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurit C... T..., me seli në F. K., për pagesën e shumës prej 2,715.00 €, sipas marrëveshjes për shërbimet juridike .

Në padi dhe gjatë seancës dëgjimore ndër të tjera ka theksuar, se paditësi me të paditurin me datë 24.07.2018, kanë lidhur marrëveshje për shërbime juridike, e paditura ka kërkuar nga paditësi që ta përfaqësoj lidhur me lëndën përmbarimore P.nr.122/2018 për realizimin e borxhit në vlerën prej 54,300.00 €, për shërbimet juridike e paditura do ta shpërblej paditësin me 5 % të shumës totale të borxhit që i bie shumën prej 2,715.00 €. Paditësi nënshkruan marrëveshje me debitorin N... C... F... C... L.L.C lidhur me lëndën P.nr.122/2018 për pagimin e borxhit, për shërbimin juridik paditësi ka lëshuar edhe faturën e rregullt me nr.23/18 të dt.27.07.2018. E paditura për ti ikë obligimeve ndaj paditësit pas pranimit të një pjese të borxhit nga N... F... bënë shkëputjen e marrëveshjes së lidhur me arsyetimin se avokati nuk ka pasur autorizimet që të lidhë marrëveshje për inkasimin e borxhit. Paditësi ka iniciuar procedurën përmbarimore lidhur me realizimin e

2020:049266

borxhit, e paditura ka paraqitur prapësim kundër propozimit për përmbarim ku Gjykata Themelore në Prishtinë e ka aprovuar prapësimin dhe e ka anuluar Urdhërin, paditësi ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit e cila e ka refuzuar ankesën me të njëjtën bazë se kreditori nuk ka paraqitur deklaratë. Ka shtuar se pasi paditësi arrin marrëveshje me N...F... C... dhe realizon shumën prej 18.000.00 €, e paditura e shpërfaqë mashtrimin dhe lajthimin të cilin e kishte planifikuar më herët dhe thekson se lënda e cila ishte tek përmbaruesi privat nuk është e të paditurës por e C... N... M.... Dis Tic.Sti. e që pretendon se është subjekt tjetër ekonomik, nga nënshkrimi i marrëveshjes se dt.06.05.2018, të nënshkruar nga e paditura dhe C... N... M.... Dis Tic.Sti., vërehet qartë se është bërë nga i njëjti person z.R. I. i cili është bashkëpronar në subjektin në Kosovë dhe në Turqi. Në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë deklarimeve si në padi dhe në seancën dëgjimore duke konsideruar se kërkesëpadia është e bazuar dhe se e paditura ka qenë e obliguar të paguaj shumën prej 2,715.00 €, meqenëse kjo shumë rrjedhë si rezultat i marrëveshjes për shërbime juridike e lidhur me dt.24.07.2018, e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj paditësit shumën prej 2,715.00 € me kamatë prej 8 % nga data kur ka qenë i obliguar ti paguaj.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe ka bërë specifikimin e tyre.

I autorizuari i të padituri, në përgjigjen në padi dhe në seancën dëgjimore ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia është tërësisht e pa bazuar sa i përket bazës dhe lartësisë, ka shtuar se paditësi ka lidhur një marrëveshje për shërbime juridike me përfaqësuesin e C... Transport Sh.p.k. kjo marrëveshje është nënkuptuar edhe si autorizim për paditësin. Paditësi ndërmerr veprime në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të entitetit biznesor "C... N... M... Dis Tic.Sti me seli në T. duke nënshkruar marrëveshje për pagimin e borxhit me "N... C... F... C..." L.L.C. Me të kuptuar pronari i kompanisë turke ka kërkuar anulimin e marrëveshjes së nënshkruar nga kompania përmes një emaili për shkak të nënshkrimit nga personi i pa autorizuar duke theksuar se paditësi dhe B. H. nuk janë të autorizuar nga kompania e tyre e që nuk ka pasur të drejt ligjërisht. Me "N... C... F... C..." L.L.C. me datën 04.09.2018, kanë lidhur marrëveshje të re për pagesën e borxhit. Ka shtuar se lidhur me të njëjtën lëndë përkatësisht objekt të kërkesëpadisë paditësi ka iniciuar procedurën përmbarimore, e që Gjykata Themelore në Prishtinë e ka abroguar duke e aprovuar prapësimin e kreditorit duke e konsideruar si të pa bazuar propozimin për përmbarim, e cila mbështetet në të njëjtën bazë dhe arsyetim sikurse në këtë padi, e të njëjtin vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë pretendimeve si në përgjigjje në padi dhe thënieve në seancën e mbajtur, ka shtuar se paditësi po kërkon borxhin lidhur me shërbimet e përfaqësimit të kryera për llogari të një etniteti krejt tjetër biznesor, për të cilin nuk ka pasur autorizim, e i padituri nuk mund të ngarkohet përtej detyrimeve të tij, ky detyrim nuk është përmbushur se i padituri nuk ka lidhur asnjë marrëveshje me etnitetin juridik N... C... F... C..." L.L.C andaj nuk mund të ngarkohet për detyrimet kontraktuale për të cilat nuk është palë. I ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar por nuk ka bërë specifikimin e tyre.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete, gjykata në procedurën e nxjerrjes së provave gjatë shqyrtimit kryesorë të datës 11.03.2021, administroj si prova: marrëveshje për shërbime juridike e dt.24.07.2018; fatura me nr.23/18 e dt.27.07.2018; shkresa e paditësit e dt.10.07.2018; autorizimi i dt.18.05.2018; certifikata e biznesit të të padituri 71297888; përgjigjja e kreditorit në prapësimin e debitorit me nr. P.nr.122/18 e dt.21.05.2018; lexohet autorizimi me nr.LRP 8540/18 e noterizuar tek noteri I. A.;

2020:049266

shkresa e Cerne Nakliat pa datë; shkresa elektronike e dt.07.09.2018; lexohet aktvendimi i përgjithshëm me nr.PP.1440/18 i dt.08.05.2019.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe pas konstatimit të fakteve jo kontestuese në mes të palëve në procedurë, gjykata konstatoj këtë gjendje faktike:

Kontestuese në mes palëve në procedurë ishte baza juridike e kërkesëpadisë, gjegjësisht përmbushja e obligimeve të marra nga Marrëveshja për shërbime juridike.

Paditësi me padi ka pretenduar se pala e paditur ka qenë e obliguar të paguaj shumën prej 2,715.00 €, në bazë të marrëveshjes për shërbime juridike e lidhur me dt.24.07.2018 , me të cilën e paditura ka kërkuar nga paditësi që ta përfaqësoj lidhur me lëndën përmbarimore P.nr.122/2018 për realizimin e borxhit në vlerën prej 54,300.00 €, nga etnitetin juridik N... C... F... C...” L.L.C, për shërbimet juridike e paditura do ta shpërblej paditësin me 5 % të shumës totale të borxhit që i bie shumën prej 2,715.00 €.

Në anën tjetër pala e paditur e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, ka pretenduar se paditësi po kërkon borxhin lidhur me shërbimet e përfaqësimit të kryera për llogari të një etniteti krejt tjetër biznesor, për të cilin nuk ka pasur autorizim.

Nga marrëveshja për shërbime juridike e dt.24.07.2018, konstatohet fakti se paditësi ka nënshkruar marrëveshjen me të paditurën, ku në emër të paditurës ka nënshkruar përfaqësuesi B. H. I njëjti është i autorizuar të përfaqësoj të paditurën përmes autorizimit me nr.LRP.nr.8540/18, autorizim i dhënë nga B. T. si pronar i të paditurës. Nga të dhënat në shkresat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për të paditurën vërtetohet fakti se pronar ka R. I. dhe M. S. I. dhe si i autorizuar F. N.. Ndërsa autorizimdhënësi B. T. nuk figuron askund si pronar që të mund të autorizonte B.H. për të lidhur marrëveshjen me paditësin, paditësi ka nënshkruar marrëveshjen me persona të cilët nuk janë të autorizuar ligjor të paditurës.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në provat e administruara dhe deklarimet e palëve në procedurë nuk rezulton se e paditura i ka borxh paditësit lidhur më kryerjen e shërbimeve juridike ashtu siç parashihet edhe nenin 8.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), me të cilën është përcaktuar se ”*pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*”. Pastaj në dispozitën e nenit 245 par.1. të LMD-së, me të cilën është e përcaktuar se “*kreditori në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme*”. E në rastin konkret nga provat e shqyrtuara në këtë çështje juridike kontestimore është vërtetuar se pala paditëse ka të nënshkruar një marrëveshje në emër të paditurës me persona të cilët nuk janë të autorizuar ligjor apo pronar, andaj i padituri nuk është i obliguar të përmbush obligimet e dala nga ajo marrëveshje. Rrjedhimisht gjykata duke u bazuar në provat e lëndës ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e palës paditëse është e pa bazuar, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera lidhur me atë se paditësi ka qenë në lajthim por një pretendim të tillë gjykata e refuzoj si të pa bazuar për shkak se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 46 të LMD-së me të cilën është paraparë se *“Lajthimi është thelbësor, nëse ka të bëjë me elementet thelbësore të objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, nëse lidhet duke marrë parasysh këtë person, si dhe me rrethanat të cilat sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta lidhte përndryshe*

2020:049266

kontratën me përmbajtje të tillë", e që në rastin konkret paditësi është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarive për të cilën edhe ka marrë licencë (Çertifikatën e Biznesit me nr.810052019), dhe është profesionalist që merret me këtë veprimtari andaj nuk mund të konsiderohet se paditësi ka qenë në lajthim apo i mashtruar me rastin e nënshkrimit të një marrëveshje kontestuese, andaj pretendimet e tilla janë jo relevante dhe nuk kishin me ndikuar ndryshe në vendosje.

Rrjedhimisht duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, rrethanat e lartcekura dhe duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të cekura me lartë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, rrjedhimisht edhe është vendosur si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

Gjykata e aprovoi kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e vonesës së kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç borxhit kryesor, paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore, në shkallën prej 8 %, duke u bazuar në nenin 305 lidhur me nenin 382.1 të LMD-së.

Me nenin 463.1 të LPK-së, është përcaktuar se për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës. Meqenëse, pala e paditur si palë gjyqe fituese ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore por nuk e ka bërë specifikimin e tyre, gjykata nuk vendosi për kompensimin eventual të tyre. Ndaj, në pajtim me nenin 463.1 të LPK-së, u vendos që secila palë të bartë shpenzimet e veta.

Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat dhe duke ju referuar nenit 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
III.EK.nr.173/20, me datën 26.04.2021

Gjyqtarja,
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

2020:049266